



UNMIK/RREG/2003/22
23 qershor 2003

RREGULLORE NR. 2003/22

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS
MBI PLEHRAT ARTIFICIALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 8.1. (a), 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh njoftimet zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 26 maj 2003 lidhur me Ligjin mbi plehrat artificiale i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 22 maj 2003,

Me anë të të kësaj shpall Ligjin mbi plehrat artificiale që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2003/10) i cili hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Nënshkruar sot, më 23 qershor 2003.

Michael Steiner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

LIGJI Nr. 2003 / 10

LIGJI PËR PLEHRAT ARTIFICIALE

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 dt.15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë, nenet 9.1 .26 (a) dhe 5.1 (j) .

Me qëllim të vendosjes së rregullave të mbrojtjes së prodhuesve e konsumatorëve të plehrave artificiale dhe sistemit rregullues të plehrave në Kosovë për të mbrojtur konsumatorin e plehrave,

Miraton ligjin vijues:

Kapitulli I – Dispozitat e Përgjithëshme

Neni 1 Përkufizimet

Në këtë Ligj :

1. **Analist** është personi i emëruar ose i caktuar në pajtim me nenin 6.
2. **Plehu artificial** është një lëndë organike ose joorganike që përmban një ose më shumë materie ushqyese të bimëve që është dedikuar për bimët e cila nxitë rritjen e bimëve dhe produktivitetin e tyre.
3. **Inspektor** është personi i emëruar ose i caktuar në pajtim me nenin 6.
4. **Etiketë** është përmbajtja e dukshme e shkruar, shtypur ose e paraqitur grafikisht në paketim ose udhëzimin që i është bashkangjitur plehut artificial.
5. **Ligji** për Plehrat artificiale është akt juridik që rregullon veprimtarinë e prodhimit , importit , përdorimit dhe tregtimit me plehra artificiale në Kosovë.
6. **Ministër**sipas këtij ligji është Ministri i MBPZHR.
7. **MBPZHR** është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
8. **Shërbim Rregullues për Plehra artificiale** është trupi i caktuar nga Ministria i cili do të jetë i ngarkuar me zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij Ligji.
9. **Administratori i Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale** do të thotë personi

i cili është i caktuar nga Ministria për të drejtuar Shërbimin Rregullues për Plehra artificiale.

10. **Bord** është Trup Këshillues për Plehra artificiale siç është përcaktuar me këtë Ligj.
11. **Person** është çdo subjekt fizik ose juridik.
12. **Regjistrim** është akti i pranimit të një personi për shitës ose prodhues të plehut artificial në Kosovë.
13. **I regjistruar** është personi i cili ka marrë certifikatë regjistrimi në pajtim me Ligjin.
14. **Shitja** përfshin ofertën, vënijen për shitje, shitjen, , shpërndarjen ose mbajtjen në zotërim për shitje ose qarkullim.
15. **Shkelje** është cenim i dispozitave të këtij Ligji .

Neni 2 Qëllimi

- 2.1. Qëllimi i këtij Ligji është sigurimi i mbrojtjes së cilësisë së plehrave artificiale në Kosovë.

Neni 3 Organizimi

- 3.1. Ministria do të përcaktojë strukturën dhe organizimin e Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale.
- 3.2. Ministria do të përcaktojë strukturën dhe organizimin e Bordit Këshillues për Plehra artificiale i cili do t'i bëjë rekomandime Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale mbi çështjet që kanë të bëjnë me këtë Ligj.

Neni 4 Regjistrimi

- 4.1. Çdo person duke përfshirë prodhuesit, importuesit ose tregtarët i cili dëshiron të shesë ose ofrojë për shitje plehra artificiale në Kosovë, do ta bëjë këtë në pajtim me qëllimet dhe kushtet e parashtuara në certifikatën e regjistrimit.
- 4.2. Kërkesa për certifikatë regjistrimi do të përfshijë:
 - a. emrin dhe adresën e të regjistruarit

b. emrin dhe adresën e çdo pike qarkulluese të të regjistruarit në Kosovë.

4.3.Kërkesa për certifikatë regjistrimi do të shoqërohet me taksën e përcaktuar. Kërkesa bëhet në formularët që do të lëshohen nga Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale.

4.4. Secila certifikatë e dhënë e regjistrimit, përveç nëse është pezulluar ose anuluar, do të jetë e vlefshme për një periudhë maksimale tri vjeçare, llogaritur prej datës së regjistrimit dhe do të përtërihet me pagesën e taksës së kërkuar për regjistrim.

4.5.Taksa e regjistrimit do të caktohet me udhëzim të veçantë administrativ,nga Qeveria.

4.6.I regjistruari do të informojë me shkrim Shërbimin Rregullues për Plehra artificiale për pikat qarkulluese shtesë të krijuara gjatë periudhës që mbulon certifikata e regjistrimit.

4.7.Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale do të lëshon certifikatën e regjistrimit brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës çdo personi që konkuron.

Certifikata e regjistrimit nuk do t'u lëshohet personave:

- (a) Nëse certifikata e mëparshme e regjistrimit është përkohësisht e pezulluar .
- (b) Nëse personi është dënuar për shkelje sipas këtij Ligji në periudhën e kaluar tri vjeçare prej datës së parashtrimit të kërkesës.
- (c) Nëse ai nuk ia bashkangjet kërkesës taksën e regjistrimit.
- (d) Nëse kërkesa s'është complete në çfardo aspekti.

4.8. Nëse Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale nuk e lëshon certifikatën e regjistrimit brenda periudhës kohore të përskruar dhe kur konkuresi ka dokumente valide, që tregojnë se një kërkesë përkatëse i është dorëzuar Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale ,konkuresi mund të fillojë shitjen e plehrave artificiale deri sa është duke pritur përgjigjen nga Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale.

4.9.Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale do të lajmërojë me shkrim konkuresin brenda afatit 30 ditësh , për arsyet e mosdhënijës së certifikatës së regjistrimit, të cekura në piken 7 të këtij neni. Mosdhënija e përgjegjes në afatin e përcaktuar konsiderohet si leje për fillimin e shitjes së plehrave artificiale deri sa është duke pritur përgjigjen.

4.10. Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale, në kohën kur lëshon certifikatën e regjistrimit do t'i ofrojë të regjistruarit një kopje të këtij Ligji .

Cilësia dhe përbërësit e dëmshëm

1. Ndalohet prodhimi, importimi, ripaketimi, vënija në qarkullim apo përdorimi i plehrave artificiale që nuk i përgjigjet cilësisë dhe kushteve tjera sipas standardeve të përcaktuara:
 - a) nuk përmban përbërës aktivë ushqyes të mjaftueshëm
 - b) përmban përbërës të dëmshëm (ndotës të mjedisit si metalet e rënda dhe radionukleide) ose ka veti të dëmshme për rritjen e bimëve edhe kur përdoret në bazë të udhëzimit.

Kapitulli II – Zbatimi

Neni 6 Inspektorët dhe Analistët, Emërimi

6.1. Inspektorët dhe Analistët që mbikqyrin zbatimin e këtij Ligji do të emërohen nga Ministria në pajtim me kushtet e përcaktuara me Udhëzim Administrativ.

Neni 7 Autorizimet e Inspektorëve

7.1. Inspektori gjithmonë mundet:

- (a) të hyjë në çdo vend për të cilin me arsye të bazuar dyshon se aty ka artikuj për të cilët vlen ky Ligj.
- (b) hapë çdo paketim të gjetur në atë vend për të cilin me arsye dyshon se ka një artikull të tillë.
- (c) ekzaminon artikullin dhe merr mostra nga ai.

7.2. Asistenca e Inspektorëve

Pronari ose personi përgjegjës i çdo vendi të përshkruar në pikën 1 të këtij neni, dhe çdo person që gjendet në atë vend do t'i ofrojë Inspektorit gjithë ndihmën e kërkuar për t'i mundësuar atij kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tij sipas këtij Ligji dhe do t'i japë Inspektorit të gjitha informatat që ai me arsye mund t'i kërkojë duke u bazuar në këtë Ligj.

Neni 8

Pengimi i Inspektorëve

- 8.1. Ndalohet pengimi i Inspektorit në kryerjen e detyrave ose funksioneve të tij të paraparë në këtë Ligj.
- 8.2. Ndalohen deklaratat e rrejshme, lajthitjet gojore ose me shkrim Inspektorit ose ndonjë zyrtari tjetër të angazhuar në kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tij sipas këtij Ligji.

Neni 9

Urdhërat “Ndalim i Shitjes”

- 9.1. Kur inspektori gjen se një sasi e plehrave artificiale është ofruar ose ekspozuar për shitje në kundërshtim të dispozitave të këtij Ligji, ai për pronarin ose mbajtësin e plehrave të tilla do të lëshojë dhe zbatojë urdhërin e shkruar “ ndalim i shitjes, shfrytëzimit, ose zhvendsojes ” dhe do ta mbajë atë në vendin e caktuar, deri në 8 ditë.
- 9.2. Inspektori do të tërheq ndalesën për plehurat artificiale, kur kërkesat e këtij Ligji të jenë plotësuar dhe të jenë paguar të gjitha shpenzimet që paraqiten në lidhje me heqjen e ndalesës së bazuar.

Neni 10

Konfiskimi, Dënimi (Shpallja e Papërdorshme) dhe Shitja

10.1. Kontigjenti i plehrave artificiale që nuk është në pajtim me këtë Ligj do të jetë objekt i konfiskimit i cili bëhet me vendim të inspektorit. Nëse inspektori konstaton se plehurat e tilla nuk u përgjigjen standardeve të parapa me Ligj dhe që plehu artificial është i papërdorshëm, ai do të asgjësohet në mënyrë adekuate dhe në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovës. Para asgjësimit të plehut artificial, pala e pa kënaqur mund të bëjë ankesë kundër vendimit të inspektorit për asgjësimin e plehut artificial, Ministrin në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Pala e pakënaqun mund ta iniciojë kontestin administrativ në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa nuk e pezullon zbatimin e vendimit të plotëfuqishëm.

Kapitulli III – Shkeljet dhe Dënimet

Neni 11

Shkeljet

- 11.1. Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale, për shkelje të përsëritura, pasi që të ketë dëgjuar të regjistruarin përkatës në një seancë shqyrtimi, mund të refuzojë, suspendojë ose anulojë çertifikatën e regjistrimit. Pas humbjes së të drejtës në çertifikatë të regjistrimit, personi në fjalë ka të drejtë ankese pranë autoritetit përkatës.

- 11.2.Do të jetë shkelje për çdo person që shet ose ofron për shitje pleh artificial që nuk i plotëson kushtet sipas këtij Ligji.
- 11.3.Kur inspektori konfiskon sasi të plehrave artificiale, ai menjëherë do t'i lëshojë , vendim ose njoftim për ndalesë në bazë të të cilit ai duhet ta vë në paketimin e materialit të tillë një etiketë vërejtjeje që deklaron se sasia është e ndaluar për shitje.
- 11.4.Sasia e plehut artificial për të cilën është lëshuar një vendim ose njoftim i ndalimit do të mbahet nga personi i cili ka kontrollin e materialit të tillë dhe nuk do vëhet në qarkullim ose lëvizet përveç nëse vepohet sipas Udhëzimeve të veqanta të Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale në pritje të vendimit në pajtim me këtë Ligj. Kjo nuk do të pengojë personin i cili ka kontrollën e materialit të verifikojë materialin e konfiskuar, e as që të marrë aty, në prezencë të personit të caktuar prej Shërbimit Rregullues për Plehra artificiale, një mostër të arsyeshme për analizë.
- 11.5.Në kërkesë të personit i cili ka kontrollin mbi plehun artificial të konfiskuar , para kohës së mostrimit prej një Inspektori, mostra e cila është marrë do të ndahet në pjesë përafërsisht të barabarta, një pjesë e së cilës do të vulozet dhe do t'i jipet personit që ka nën kontroll plehun artificial të konfiskuar dhe pjesa tjetër e saj do të mbahet për analiza nga Shërbimi Rregulues për Plehra artificiale.
- 11.6.Nëse analizat e sasisë së konfiskuar dhe mbajtur, siç është përcaktuar prej Analistit, tregojnë se nuk është shkelur Ligji, Inspektori menjëherë do të zhbllokojë sasinë e konfiskuar dhe e mbajtur dhe do të heq etiketën ose urdhëresën e ndalimit.
- 11.7.Nëse sasia e konfiskuar dhe e mbajtur është në kundërshtim me Ligjin, Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale do t'i ndërmarrë ndonjërin nga veprimet e mëposhtme:
- (a).Vazhdon ta mbajë sasinë e plehrave artificiale deri sa të mos përmbushen kërkesat e këtij Ligji për heqjen e ndalesës.
 - (b).Ndërmerr procedurën , sipas nenit 10 të këtij ligji.
- 11.8.Personi i cili ka kontrollin mbi sasinë e konfiskuar dhe të mbajtur për të cilën është konstatuar se nuk është në pajtim me Ligjin, mund të ankohet me shkrim për rezultatin e analizave të Shërbimi Rregullues për Plehra artificiale brenda kohës së përcaktuar . Me pranimin e ankesës së tillë, Inspektori mostrën shtesë nga kontigjenti në fjalë do ta dërgojë për superanalizë. Shpenzimet e mostrimit dhe analizave do ti bartë personi që kërkon përsëritjen e analizës. Rezultatet e analizave pas ankesës do të jenë përfundimtare.

Neni 12

Keqpërdorimi i Markës së Plehrave Artificiale

- 12.1.Ndalohet ofrimi për shitje ose shpërndarja e plehrave artificiale me markë të falsifikuar.
- 12.2.Plehu artificial do të konsiderohet të ketë markë të falsifikuar:

- (a) Nëse identifikimi ose etiketimi i tij është fals ose lajthitës në çfardo mënyre.
- (b) Nëse është shitur, shpërndarë ose ofruar për shitje me emrin e një plehu artificial tjetër.
- (c) Nëse nuk është identifikuar ose etiketuar siç është përcaktuar .

Neni 13 Falsifikimi

13.1. Ndalohet shpërndarja e prodhimit të falsifikuar të plehrave artificiale .

13.2. Plehu artificial do të konsiderohet i falsifikuar :

- (a) Nëse përmban përbërës të dëmshëm mbi masën e lejuar dhe që e bënë të dëmshëm për jetën e bimëve, shtazëve, njerëzve, jetën në ujë, tokën ose ujin, kur të jetë përdorur në pajtim me udhëzimet e përdorimit, ose kur në etiketë nuk janë dhënë vërejtjet përkatëse ose udhëzimet përdorimit që mund të jenë të domosdoshme për mbrojtjen e jetës së bimëve, njerëzve, kafshëve, tokës, jetës ujore apo nënujore.
- (b) Nëse përbërja e materieve të dobishme bie nën ose ndryshon prej asaj që është deklaruar të posedojë në bazë të identifikimit dhe etiketës së saj.
- (c) Nëse përmban farë, shtesa tjera të padëshiruara të bimëve ose barojave të këqija.

Neni 14 Mungesa në Peshë

14.1. Nëse në paketim të plehrave artificiale në posedim të një të regjistruari është gjetur të ketë mungesë në peshë mbi një përqind kjo konsiderohet shkelje nga ana e të regjistruarit.

Neni 15 Dispozitat ndë shkimore

15.1. Me denim me gjobë në shumë prej 5.000 deri në 20.000 euro dënohet personi që:

- prodhon, importon, ripaketon ose vë në qarkullim plehrat artificiale të cilat nuk i përgjigjen cilësisë sipas standardeve të përcaktuara. (neni 5)
- merret me prodhimin, importimin, ripaketimin ose shitjen e plehrave artificiale e për këtë nuk është i regjistruar (neni 4)
- vënë në qarkullim plehrat artificiale në kundërshtim me kushtet e certificates
- shet sasinë e plehut artificial për të cilën është lëshuar ndalesa për shitje (neni 9)

- shet prodhim të falsifikuar të plehrave artificiale (neni 13)

15.2. Nga pika 1 e këtij neni, përveç dënimit do të shqiptohet edhe masa mbrojtëse e marrjes së përfitimit të arritur me shitjen e plehrave artificiale jo cilësor si dhe marrja e tërë sasisë së plehut artificial nga importi nëse nuk i përgjigjet cilësisë së përcaktuar apo përmban materje të dëmshme.

15.3. Me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 deri në 15.000 euro dënohet personi që:

- vë në qarkullim plehra artificiale me markë të falsifikuar (neni 12)

- vë në qarkullim plehra artificiale pa etiketë në paketim

- importon plehra artificial pa certifikatë të cilësisë dhe origjinës (neni 12.2/c).

- pengon inspektorin në kryerjen e detyres zyrtare apo i jep inspektorit deklaratë të rrejshme (neni 8)

- nuk i ofron ndihmë inspektorit në kryerjen e detyrës (neni 7.2)

- vë në qarkullim plehra artificiale me mungesë në peshë (neni 14)

Neni 16

Të hyrat e krijuara nga taksat

16.1. Të hyrat e krijuara nga taksat për shërbime dhe gjobat sipas këtij Ligji barten në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për ti derdhur në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës

Kapitulli IV – Udhëzimet Administrative

Neni 17

Udhëzimet

17.1. MBPZhR është përgjegjëse për nxjerrjen e udhëzimeve dhe vendimeve administrative lidhur me plehrat artificiale.

Kapitulli V – Dispozitat Përfundimtare

Neni 18

Shfuqizimi

18.1. Ky Ligj shfuqizon çdo dispozitë të Ligjit në fuqi, nga lëmia e plehrave artificiale e

që është në kundërshtim me te.

Neni 19

Kompetencat dhe përgjegjësitë e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara

Të gjitha funksionet e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën („PSSP,“) sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/9 mbi Komizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohëshme në Kosovë, përkohësisht janë lëndë e monitorimit dhe miratimit të PSSP.

Neni 20

Hyrja në fuqi e këtij Ligji

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e parë pas miratimit.

Ligji nr. 2003 / 10
22 Maj 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës ,

Akademik Nexhat Daci